



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	18.02.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Janar

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 03.01.2026 deri me 31.01.2026

Lipjan 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Muaji janar ka shënuar fillimin e aktiviteteve për vitin 2026, me fokus të veçantë në planifikimin, organizimin e punëve dhe koordinimin e aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar takime pune me stafin profesional, me qëllim të përcaktimit të prioritetëve vjetore dhe sigurimit të një qasjeje të mirëkoordinuar për realizimin e projekteve në mbështetje të fermerëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor në komunë.

Në fillim të muajit është mbajtur takim i përbashkët me të gjithë stafin e Drejtoratit të Bujqësisë, ku është shqyrtuar dhe diskutuar plani vjetor i punës për vitin 2026. Gjatë muajit janar është finalizuar dhe dorëzuar plani vjetor i punës i Drejtoratit të Bujqësisë, i cili përfshin aktivitetet dhe projektet që do të realizohen gjatë vitit 2026 në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë dhe rritjes së prodhimit vendor. Gjithëashtu, kemi diskutuar edhe për procesin e subvencioneve dhe pagesave direkte, si dhe në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve që ofrohen për fermerët, veq kësaj, kemi trajtuar gjithashtu sfidat dhe ndryshimet e nevojshme në procedurat e subvencioneve dhe pagesave direkte, të cilat pritet të hapen si zakonisht në fillim të pranëverës. Është theksuar rëndësia e koordinimit të mirë ndërmjet stafit, me qëllim të menaxhimit sa më të rregullt të fluksit të fermerëve dhe sigurimit të një procesi të lehtësuar të aplikimit.

Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve për pajisje bujqësore (freza dhe spërkatëse) ka vazhduar punën në shqyrtimin e aplikimeve dhe përpilimin e listës së përfituesve nga thirrja publike e vitit 2025. Ky proces është në fazën përfundimtare dhe synon një përzgjedhje të drejtë dhe transparente të fermerëve përfitues.

Gjatë muajit janar është hapur procesi i aplikimit për programin e cilësisë dhe sasisë së qumështit, program i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ky program ka për qëllim mbështetjen e fermerëve të sektorit të blegtorisë përmes vlerësimit të prodhimit të qumështit dhe ofrimit të subvencioneve për fermerët blegtor.

Fermerët janë duke dorëzuar aplikimet e tyre në Drejtoratin e Bujqësisë në komunë, ndërsa të gjitha lëndët e pranuar janë në proces të përcjelljes në Ministrinë e Bujqësisë për shqyrtim.

Në kuadër të përgatitjeve për sfidat që mund të paraqiten gjatë vitit, gjatë muajit janar është formuar Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve në Bujqësi për vitin 2026. Ky komision ka për detyrë: vlerësimin e kërkesave të fermerëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (breshër, thatësi, përmytje etj.) hartimin e raporteve vlerësuese dhe rekomandimin e masave mbështetëse për fermerët e prekur.

Gjatë muajit janar, si pasojë e reshjeve të shumta të shiut, në disa zona janë regjistruar përmytje të konsiderueshme të tokave bujqësore. Ekipet emergjente dhe komisioni përkatës kanë qenë vazhdimisht në terren për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

Fermerët e dëmtuar kanë paraqitur kërkesat e tyre në komunë, ndërsa sipas të dhënave të komisionit janë regjistruar mbi 80 kërkesa për vlerësim të dëmeve në bujqësi.

Gjatë muajve në vijim, Drejtoria e Bujqësisë do të vazhdojë zbatimin e planeve dhe projekteve të planifikuara, me qëllim të rritjes së qëndrueshme të sektorit bujqësor, përmirësimit të kushteve dhe rritjes së mbështetjes për fermerët.

Fokusi kryesor do të mbetet përkrahja përmes subvencioneve, përmirësimit të shërbimeve sa më të mira për fermerët tanë.